

RMC ECF CONSORTIUM HOLDING S.A.L.

STATUTI

Kapitulli I - KUSHTET E PERGJITHSHME

Lloji i Kompanisë, Emri, Statusi Ligjor, Objekti, Zyra Kryesore dhe Kohëzgjatja

10 Lloji i Kompanisë :

Një Kompani Aksionere " Holding " është formuar me anë të këtij dokumenti nga dhe midis nënshkruesve e zotëruesve të aksioneve të shpallur ose që mund të shpallen që këtej e tutje.

11 Emri :

Emri i Kompanisë do të jetë :

RMC ECF CONSORTIUM HOLDING S.A.L.

12 Statusi Ligjor :

Kjo Kompani do të drejtohet me anë të kushteve mandatore të ligjeve tregtare libaneze dhe përdorimet e tij, veçanërisht ato të Dekretit Legjislativ nr. 45 të datës 24/6/1983, dhe me anë të kushteve të vëna nga statuti në fjalë.

13 Objektivi :

Objektivi i Kompanisë do të jetë :

13.1 blerje aksionesh ose pjesësh në:

Ndërmarrjen e Prodhimit të Çimentos të Fushë -Krujës në Shqipëri (Fabrika e Çimentos e Fushë-Krujës, Shqipëri) dhe në manaxhimin e Kompanisë së thënë si direkt edhe indirekt nëpërmjet Kompanive, në të cilat Kompania në fjalë zotëron aksione ose pjesë ose është pjesëmarrëse në formimin e tyre për këtë qëllim, dhe në përfaqësimin e Kompanisë në fjalë dhe në përmbushjen e objektivit të saj dhe të aktiviteteve nëpërmjet Kompanive në të cilat Kompania në fjalë zotëron aksione ose pjesë, ose merr pjesë në formimin e tyre.

13.2 për qëllimin e sipërpërmendur, Kompania do të ketë të drejtën e blerjes së aksioneve ose pjesëve në Kompanitë aksionere ekzistuese ose në Kompanitë me përgjegjësi të kufizuara, libaneze ose të huaja, ose të marrë pjesë në krijimin e Kompanive të tilla.

13.2.1 Megjithatë, Kompanisë nuk i lejohet të zotërojë drejtpërdrejt një masë që kapërcen 40 përqind të kapitalit, në më shumë se dy Kompani që kryejnë të njëjtin aktivitet industrial ose tregtar ose jo-tregtar në Liban, në rast se ky

aksioner thyen përkufizimet e parashikuara nga neni 1 I Dekretit Legjislativ nr.32 të datës 15 gusht 1967.

Këto përkufizime nuk aplikohen për investime jashtë Libanit.

13.3 të manaxhojë Kompani në të cilat Kompania në fjalë zotëron aksione ose pjesë.

13.4 Të japë hua për Kompanitë në të cilat Kompania në fjalë zotëron pjesë ose aksione dhe të bëhet garant për kompani të tilla kundrejt palëve të treta.

13.4.1 Për këtë qëllim, Kompania do të ketë për detyrë të marrë hua nga bankat dhe të nxjerrë letra me vlerë në bazë të përkufizimeve të nenit 2, paragrafit 3 të Dekretit Legjislativ nr. 45/83 dhe të përkufizimeve të paragrafëve 30, 31 dhe 32 të statuteve prezentë.

13.4.2 Megjithatë, Kompanisë nuk i lejohet të marrë hua tek Kompanitë që operojnë në Liban, vetëm në rast se pjesa e saj në kapitalin e Kompanisë huamarrëse është më pak se 20%.

13.5 Blerjen e Patentave të shpikjeve, zbulimeve, të drejtën e licensës dhe kuotat e regjistrimit dhe të drejta të tjera të autorit dhe kontrata qiradhënieje si për ndërmarrjet e vendosura në Liban, edhe për ato që janë në vende të tjera.

13.6 Blerje e pasurive të tundshme me kusht që ato të jenë të caktuara vetëm për nevojat e punëve të Kompanisë.

14 Zyra Qëndrore

14.0 Zyra Qëndrore e Kompanisë do të jetë në Rabieh, Caza of Metn,

14.1 Zyra Qëndror mund të transferohet në çdo vend tjetër në Liban në sajë të një rezolute të aprovuar në një mbledhje (të jashtëzakonshme) të veçantë të aksionerëve.

15 Kohëzgjatja :

Kohëzgjatja e Kompanisë do të jetë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite duke u nisur nga data e krijimit të saj përfundimtar, vetëm në rast se shpërndahet më parë ose nëse shtrihet mjaftueshëm me anë të një rezolute të miratuar në një mbledhje të veçantë të aksionerëve, me kusht që të gjitha kontratat që janë të detyrueshme për Kompaninë të shqyrtohen.

Kapitulli II

Kontributet, Kapitali, Aksionet

20 Kontributet :

Të gjitha kontributet origjinale që përbëjnë kapitalin fillestar të kompanisë përfaqësojnë kontributet në cash.

21 Kapitali I kompanisë :

21.1 Shuma Totale :

Kapitali i Kompanisë është i caktuar në shumën /1.000.000/ USD (një milion) të ndarë në 1000 (një mijë) aksione nga /1000/USD (një mijë) secila.

21.1.1 Shumat e paguara nga nënshkruasit do të depozitohen në një bankë të rënë dakort në bazë të kushteve të dhëna nga ligji.

21.1.1.1 Secili nënshkruesi i kërkohet të bëjë në cash një pagesë minimale prej një të katërtën të aksioneve të vlerës totale të saj.

21.1.1.2 Zotëruesi i një aksioni që nuk është paguar, është i detyruar ti përgjigjet kapitalit të kompanisë.

21.1.1.3 Nëse aksionet nuk janë paguar deri në maturitet, kompania mund që, pas thirrjeve të bëra për tu paraqitur në adresë të aksionerit në mungesë të tij, sipas parashikimeve të bëra në ligj, shet aksionet në fjalë në bursë për llogari të nënshkruarit në mungesë të tij, dhe në bazë të përgjegjësiave të tij.

21.2 Shtimi i Kapitalit

21.2.1 Kapitali i Kompanisë mund të shtohet njëhërë ose më shumë me anë të një mbledhjeje të veçantë të aksionerëve, sipas rekomandimit të Bordit të Drejtorëve, me kusht që kapitali i mëparshëm është paguar plotësisht.

21.2.2 Shtimi i Kapitalit arrihet duke nxjerre aksione të reja me ose pa nxjerrjen e primit të sigurimit ose duke rritur vlerën nominale të aksioneve ekzistuese.

21.2.3 Aksionet e reja paguhen me cash; ose me kompensim me kredi likuide të caktuara nga kompania në përputhje me kreditorët; ose me anë të inkorporimit të rezervës stëtuore ose fondeve të veçanta rezervë, ose me primit e sigurimit, ose me anë të përfitimeve; ose me anë të kontributeve në natyrë, të cilat do të vlerësohen në përputhje me kushtet e nenit 86 dhe vazhdimet e ligjit tregtar; ose me anë të konversionit të bonove të kompanisë në përputhje

me kushtet e nenit 9 të Dekretit Legjislativ nr. 54/77, dhe përgjithësisht me anë të të gjitha mjeteve ligjore.

21.2.4 Mbledhja e veçantë e aksionerëve, që vendos për shtimin e kapitalit, do të caktojë modalitetet dhe kushtet e këtij shtimi dhe do ti japë Bordit të Drejtorëve të gjitha kompetencat për arritjen e këtij shtimi.

21.3 Pakësimi i Kapitalit

Aksionerët mund të vendosin në një mbledhje të veçantë të pakësojnë kapitalin e kompanisë për çfarëdo lloj arsyeje dhe në çfarëdolloj mënyre, veçanërisht duke rimbursuar aksionerët ose duke blerë dhe anuluar aksionet, ose duke shkëmbyer aksionet për të tjeramme kusht që një vendim i tillë nuk çënon të drejtat e palëve të treta dhe nuk pakëson kapitalin nën minimumin e lejuar me ligj.

21.4 Amortizimi i Kapitalit

Kompania mund që me anë të një rezolute të miratuar nga aksionerët në një mbledhje të radhës të amortizojnë kapitalin e kompanisë totalisht ose pjesërisht pa e pakësuar atë, duke caktuar një pjesë të përfitimeve të tij për amortizim ose për një fod rezervë të veçantë, dhe këto të fundit të caktuara për tu zbatuar, dhe me konversion të aksioneve të amortizuara në aksione në bazë të përkufizimeve të parashikuara në ligj.

22 Aksionet :

22.1 Llojet e Aksioneve :

Aksionet e Kompanisë do të jenë aksionet që i përkasin mbajtësit të tyre.

22.1.1 Nëse aksionet nuk paguhen plotësisht me nënshkrimin e marrjes së tyre, aksioneri do të përfitojë një faturë ose një certifikatë nominale të përkohshme duke konfirmuar këstin e parë të vlerës së aksioneve dhe në bazë të të cilave do të përmenden këstet me radhë.

Çertifikata e fundit e aksionit do të jepet me përcaktimin e plotë të vlerës së aksioneve.

22.1.2 Çertifikatat nominale të përkohshme dhe certifikatat e fundit të aksioneve do të shkëputen nga një amë e blokut të çekut; ato do të kenë një numër serie dhe do të përmendin numrat e aksioneve të cilat ato përfaqësojnë.

Çertifikatat e aksioneve do të mbajnë gjithashtu edhe vulën e kompanisë dhe do të firmosen nga Kryetari I Bordit të Drejtorëve dhe një anëtar I Bordit.

22.2. Pandashmëria :

Një akion është I pandashëm kundrejt kompanisë që njih një zotërues të vetëm për çdo akcion.

22.3 Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi I aksioneve :

- 22.3.1 Çdo aksion I jep zotëruesit të drejtat që I bashkëngjiten dhe midis atyre, të drejtën për të marrë dividendë, për tu regjistruar kur rrisin kapitalin, për tu rimbursuar për vlerën nominale të aksionit dhe për të patur pjesë proporcionale në aktivet e kompanisë, dhe të gjitha të lartpërmendurat në përputhje me vlerën që përfaqësojnë në kapital.
- 22.3.2 Çdo aksion I jep të drejtën zotëruesit për të marrë pjesë në mbledhjet e aksionerëve për të diskutuar dhe për të votuar në përputhje me ligjin dhe rregulloret.
- 22.3.3 Në parim, të gjithë aksionerët duhet të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të jenë pjesëmarrës po në të njëjtat përfitime.
- 22.3.4 Një letër me vlerë e një aksionisti do të kufizohet me vlerën nominale të aksioneve që ka në zotërim. Nuk mund të bëhet asnjë pretendim kundrejt tij nga kompania për pagim të tepërt të asaj vlerë me përjashtim të rasti kur shprehimisht parashikohet me ligj dhe rregullore.
- 22.3.5 Zotëruesi I një aksioni nënkupton që ai pranon statutet e kompanisë, rezolutat e miratuara siç është parashikuar nga mbledhjet e përgjithshme dhe çdo modifikim që mund të bëhet në bazë të parashikimeve të bëra me ligj dhe nga statutet.

22.4 Transferimi I aksioneve :

Në bazë të kushteve të ligjit tregtar që ka lidhje me "aksionet e kualifikimit" të caktuara për të dhënë siguri për përgjegjësinë e Drejtorëve, dhe të cilat do të mbeten në formën e regjistruar dhe nuk do të jenë të negociueshme, aksionet e zotëruesit patjetër që mund të transferohen me mënyrën e thjeshtë ose me kundërfirmim të çertifikatës që ka lidhje me aksionet e transferuara në bazë të porosisë së transferuesit. Këto aksione konsiderohen kundrejt kompanisë dhe palëve të treta si pronë e cilitdo që është zotëruesi i tyre.

Kapitulli III

30. Nxjerrja e Bonove :

- 30.1 Kompania mund të nxjerrë bono të negociueshme dhe të pandashme me vlerë të barabartë nominale për t'ia dërguar nënshkruesve në përfaqësimin e shumave të dhëna hua nga ana e tyre kompanisë.
- 30.1.1 Kompania nuk mund të nxjerrë bono derisa kapitali i plotë i kompanisë të jetë likuiduar plotësisht.
- 30.1.2 Vlera totale e Bonove të nxjerra nga kompania nuk duhet të kapërcejnë, në çfarëdo kohë, shumën

Bonot do të hiqen nga ama e bllokut të çekut dhe do të nënshkruhen në bazë të të njëjtave kushte që aplikohen për aksionet.

30.3 Me mbarimin e punës, emëtimi I bonove do të shfaqet në regjistrin e veçantë tregtar të Kompanive Holding nën kujdesin e Bordit të Drejtorëve.

31 Bonot e Pakonvertueshme :

31.1 Nxjerrja e bonove të pakonvertueshme duhet të vendoset me anë të një mbledhjeje të radhës të përgjithshme të aksionerëve sipas kushteve të neneve 122 deri në 143 të ligjit tregtar.

31.2 Mbledhja e përgjithshme e aksionerëve mund ti delegojë Bordit të Drejtorëve kompetencat e duhura për të nxjerrë bonot me short ose me intervale dhe për të vendosur për modalitetet.

31.3 Vlera e pagesës së bonove do të bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në kohën e nxjerrjes së tyre. Kompania nuk mund ta ndryshojë më parë datën e kësaj pagese ose ta vonojë atë.

31.3.1 Nëse vlera e bonove nuk është paguar plotësisht që në fillim dhe angazhimi i kompanisë për të paguar bilancin e kësaj vlere bëhet pa sukses, kompania mund të shesë bonot në bursë.

31.4 zotëruesit e bonove mblidhen në një grup që vetë krijohet për çdo çështje.

31.4.1 mbledhja e përgjithshme e zotëruesve të bonove mblidhet dhe mbahet në bazë të parashikimeve në ligj dhe kurdo që mendohet që është e rëndësishme.

Vendimet e kësaj mbledhjeje të miratuara me maxhorancë janë të detyrueshme për të gjithë.

32 Bonot e Konvertueshme në Aksione

32.1 Kompania mund të nxjerrë bono të konvertueshme në aksione në përputhje me parashikimet e nenit 9 të Dekretit Legjislativ nr. 54/57.

32.2 Nxjerrja e bonove të sipërpërmendura duhet të vendoset me anë të mbledhjeje të veçantë (të jashtëzakonshme) të aksionerëve të mbledhur posaçërisht për këtë çështje.

3.2.1 Vendimet e kësaj mbledhjeje të veçantë të aksionerëve miratohen me shumicë votash të përcaktuara nga nenet 193 dhe 195 të Ligjit Tregtar.

3.2.3 Aksionerët do të kenë të drejtën e prioritetit për regjistrim për bonot e konvertueshme në aksione në proporcion me zotërimin e aksioneve të tyre përkatëse dhe mbi baza të pareduktueshme, përveç rastit kur një vendim I kundërt është marrë nga mbledhja e veçantë e aksionerëve, të mbledhur posaçërisht për të aprovuar dhënien e licensës për këtë qëllim.

- 3.2.4 Bonot e konvertueshme nuk mund të nxirren për një vlerë që është më pak se vlera nominale e aksioneve që do të jepen zotëruesve të bonove nëse ata vendosin për të konvertuar bonot e tyre në aksione.
- 3.2.5 Konversioni i bonove në aksione do të bëhet në bazë të dëshirës së zotëruesit të tyre dhe në bazë të kushteve të përcaktuara me nxjerrjen e patentës.
- 3.2.6 Aksionet e dhëna zotëruesve të bonove si rezultat i konversionit të bonove të tyre, përfitojnë nga dividendët e shpërndarë për vitin financiar brenda së cilës është bërë kërkesa për konversion.

Kapitulli IV

Manaxhimi i Kompanisë

4.0 Bordi i Drejtorëve :

4.0.1 Përbërja e Bordit :

4.0.1.1 Kompania do të manaxhohet nga një Bord i Drejtorësh të përbërë nga jo më pak se tre dhe jo më shumë se dymbëdhjetë anëtarë.

4.0.1.1.1 Vetëm dy anëtarë të Bordit të Drejtorëve duhet të jenë persona fizikë të kombësisë Libaneze.

4.0.1.2 Bordi i parë i Drejtorëve do të zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme kushtetuese.

4.0.1.3 Mbledhja vjetore e radhës e aksionerëve do të zgjedhë Bordin vijues të Drejtorëve nga aksionerët.

4.0.1.3.1 Mbledhja e sipërpërmendur mund të shkarkojë nga detyra Drejtorët në përputhje me përcaktimet e neneve 150 dhe 151 të Ligjit Tregtar.

4.0.1.3.2 Mbledhja e përgjithshme e zakonshme e aksionerëve mund të modifikojë numrin e drejtorëve duke u mbështetur në klauzolat e paragrafëve 40 11 dhe 40 111 të këtyre statuteve prezente.

4.0.1.4 Drejtorët do të zgjidhen nga aksionerët si persona fizikë edhe juridikë.

40 141 Asnjë person nuk mund të caktohet si anëtar i Bordit të Drejtorëve nëse ai nuk përmbush të gjitha kushtet e parashikuara me ligj.

41 142 Personat juridikë, anëtarë të Bordit të Drejtorëve do të caktojnë një përfaqësues të përhershëm që i nënshtrohet të njëjtave kushte dhe detyrime dhe që merr përsipër detyrime civile dhe penale si të ishte në rolin e Drejtorit pa çenuar detyrimet e përbashkëta të personit juridik që ai përfaqëson.

41 15 Në rast se midis dy mbledhjeve të zakonshme vjetore të aksionerëve, numri i Drejtorëve në detyrë zvogëlohet nën tre, me vdekjen, dhënien e dorëheqjes ose ndonjë

rast tjetër, ose nëse numri I personave fizikë libanezë, që janë anëtarë të Bordit, zbret nën dy vetë, Drejtorët që mbeten do të mbajnë një mbledhje të aksionerëve brenda një kohe limit maksimale prej dy muajsh, në mënyrë që të zgjidhen Drejtorët që do të zënë vendet e mbetura bosh.

40 16 çdo lloj ndryshimi në përbërjen e Bordit të Drejtorëve duhet të shkruhet në regjistrin e veçantë tregtar të kompanisë financiare nën kujdesin e anëtarëve të Bordit në përputhje me parashikimet e dhëna me ligj.

40 2 Aksionet e Kualifikimit :

40 21 çdo Drejtor do të zotërojë gjatë gjithë periudhës së detyrës së tij një numër minimal aksionesh që përfaqësojnë të paktën 1% (një për qind) të numrit total të aksioneve të kompanisë.

40 22 këto aksione do të mbeten nominative dhe të panegociueshme. Ato do të shënohen si të "pa transferueshme" dhe do të depozitohen në kasafortën e kompanisë.

40 23 këto aksione do të caktohen të japin siguri për detyrimet kolektive ose individuale të Drejtorëve për të gjitha aktet e menaxhimit të gabuar në përputhje me klauzolat e ligjit.

40 24 Në ras tse një nga Drejtorët gjatë detyrës së tij, do të ndalojë së zotëruari të gjithë ose pjesë të aksioneve të kualifikimit, ai do të jetë automatikisht I detyruar të japë dorëheqjen nëse nuk rregullon situatën menjëherë.

40 25 Aksionet e kualifikimit nuk mund ti kthehen Drejtorëve në fund të afatit të qëndrimit në detyrë derisa ti kenë përmbushur detyrimet me aprivim të llogarive të kompanisë të vitit financiar në të cilin ata janë në detyrë.

40 3 Periudha e Qëndrimit në Detyrë

40 31 Periudha e Qëndrimit në Detyrë e Bordit të Drejtorëve nuk duhet të kalojë tre vjet.

40 311 "viti" nënkupton periudhën midis dy mbledhjeve vijuese vjetore të zakonshme të aksionerëve.

40 32 Drejtorët në vijim mund të rizgjidhen pa ndonjë kufizim ligjor numrit të rinovimit të postit të punës.

41 Kryetari I Byrosë së Bordit

41 1 Drejtorët do të zgjedhin midis tyre një Kryetar për Bordin në bazë të klauzolave të parashikuara me ligj për një periudhë që nuk mund të kalojë atë të postit të tij si Drejtor.

Kryetari do të jetë person fizik dhe jo përfaqësues I një personi juridik.

41 2 nëse është e rëndësishme, Bordi I Drejtorëve mund të caktojë një Nën-Kryetar detyra e të cilit është e limituar në drejtimin e seancave të Bordit të Drejtorëve dhe të mbledhjeve të përgjithshme të aksionerëve, në rast se Kryetari nuk mund të jetë prezent.

41 21 Nëse Bordi I Drejtorëve nuk e ka caktuar një Nën-kryetar dhe nëse Kryetari nuk mund të jetë prezent, Drjtorët mund të caktojnë në çdo mbledhje një prej tyre për të drejtuar seancën.

41 3 Bordi I Drejtorëve mund të caktojë një nga anëtarët e tij ose nga ndonjë vend tjetër një sekretar, periudha e detyrës së të cilit do të jetë e njëjtë me atë të Bordit.

41 4 Bordi I Drejtorëve mund të caktojë, me kërkesë të Kryetarit, një Manaxher të Përgjithshëm, me kusht që manaxheri i caktuar do të kryejë detyrat e tij për llogari të Kryetarit dhe mbi përgjegjësitë e tij personale.

41 5 Bordi I Drejtorëve mund të caktojë një Komitet Këshillues të përbërë nga anëtarë të Bordit ose nga manaxherët e caktuar diku tjetër ose nga anëtarët dhe manaxherët.

41 6 Në rast se Kryetarit të Bordit I është ndaluar të kryejë detyrat e tij, ai mund të caktojë një anëtar të Bordit të Drejtorëve për të kryer të gjitha ose pjesë të detyrave të tij me kusht që një post i tillë do të jetë për një periudhë të caktuar.

Në rast se Kryetarit të Bordit I është ndaluar të kryejë detyrat e tij, Bordi I Drejtorëve mund ta mbajë atë për të dhënë dorëheqjen dhe do të zgjedhë një Kryetar të ri.

42 Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve,

Njoftimi për mbledhjet, Rezolutat :

42 I Mbledhja e Bordit :

43 11 Bordi I Drejtorëve do të mbledhet me njoftim të dërguar nga Kryetari kurdo që është e nevojshme për interesin e kompanisë. Bordi do të mbledhet të paktën njëherë në vit për të aprovuar llogaritë e vitit financiar të kaluar dhe për të mbledhur mbledhjen vjetore të përgjithshme të aksionerëve.

42 12 Njoftimet për mbledhjet mund të dërgohen me anë të të gjitha mjeteve të përshtatshme. Mund të dërdogen edhe me anë të një note verbale.

42 13 Axhenda e mbledhjeve duhet të jetë e caktuar nga kryetari i Bordit në shënimet e mbledhjeve, ose edhe gjatë mbledhjeve.

42 14 Nëse Bordi I Drejtorëve nuk mban ndonjë mbledhje gjatë dy muajve të fundit, një e treta e anëtarëve të tij të paktën duhet të bindë Drejtuesit për të mbajtur një mbledhje sipas axhendës së treguar.

42 2 Vendi I mbledhjeve:

Bordi I Drejtorëve duhet të mbahet në Zyrën Qëndrore të kompanisë, ose në ndonjë vend tjetër të treguar në shënime, qoftë jashtë territoreve libaneze, siguruar nëse është aprovuar nga gjysma e numrit të Drejtorëve.

42 3 Kuorumi I Bordit:

42 31 Prezenca personale ose me prokurë e të paktën gjysmës së Drejtorëve duhet të jetë e domosdoshme për të krijuar një kuorum të një mbledhjes së Bordit.

42 32 Një drejtor duhet të autorizojë një tjetër Drejtor për të përfaqësuar atë dhe për të votuar për të duke u siguruar që cdo Drejtor do të përfaqësojë vetëm një tjetër.

42 4 Resolutat e Bordit:

Resolutat e Bordit duhet të jenë të pranuar nga shumica e votave të drejtorëve prezent ose të përfaqësuar.

42 5 Procesverbali I mbledhjeve:

Të gjitha diskutimet e Bordit duhet të jenë hedhur në letër me procesverbal të firmosura nga Kryetari dhe të gjithë Drejtorët prezent ose të përfaqësuar.

Këto procesverbale duhet të mbahen në një regjister special të mbajtur në zyrën qendrore të kompanisë.

43 Pushteti I Bordit dhe Kryetarit:

Pushteti I Bordit:

Bordi I Drejtorëve duhet të ketë pushtetin me të gjerë për të hartuar rezolutat e mbledhjeve të Përgjithshme dhe për të përfunduar të gjitha aktet, të cilat duhet të jenë të domosdoshme për të siguruar drejtimin e punëve dhe administrimin e Kompanisë në mënyrën e zakonshme dhe të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga veprimet e përditshme; dhe pushtete të tilla nuk kanë limite ose kufizime përveç atyre që siguron ligji ose statusi aktual.

Bordi I Drejtorëve duhet të ketë në veçanti pushtetet e mëposhtme, të cilat janë përmendur si një tregues dhe jo si një kufizim.

- Të ngrejë në opinionet e veta rregullat e brendshme të kompanisë, dhe të emërojë menaxherë, nënshkrues të autorizuar dhe të punësuar, të përcaktojë kushtet e punësimit të tyre dhe pagat e tyre dhe të vendosë shkarkimin e tyre nga punësimi dhe zëvendësimin e tyre nga të tjerë.
- Të emërojë, pushojë dhe zëvendësojë agjentët dhe përfaqësuesit e Kompanisë dhe të përcaktojë kushtet e kontraktimit të tyre, të cilat duhet të jenë nxjerrë me ta.

- Përvetësimi I aksioneve ose pjesëve në kompanitë aksionere ekzistuese ose kompanitë me përgjegjësi të kufizuar, libaneze ose të huaja, ose pjesëmarrja në krijimin e kompanive të tilla.
- Në përgjithësi të përmbushë të gjitha kontratat që janë të lidhura me objektivin e kompanisë të çfarëdo lloj natyre brenda kushteve që ata gjykojnë të përshtatshme.
- Të ngrejë degët e Kompanisë në Liban ose jashtë tij.
- Të përfundojë, shfuqizojë, anulojë dhe të paracakttojë qiradhëniet.
- Të përcakttojë administratën dhe shpenzimet e përgjithshme për drejtim të biznesit të Kompanisë.
- Të kryejë punë në emër të Kompanisë me të gjitha veprimet me bankat nga hapjet, qarkullimet dhe mbylljet e të gjitha llojeve të llogarive, etj...
- Të përfundojë të gjitha huatë për të tilla interesa dhe nën kushte të tilla që ata mund t'i gjykojnë të përshtatshme.
- Të grumbullojë ndonjë shumë të çfarëdo sasive për llogari të Kompanisë nga ndonjë institucion publik, bankë, institucion privat dhe ndonjë person fizik ose juridik dhe të japë faturat dhe shlyerjet e nevojshme.
- Te firmose, te zhvillojë bisedime, te mbeshtese dhe te garantoje zbatuesit e shenimeve te premtuara, drafteve, verifikimeve dhe letrave tregtare.

43 12 Bordi I Drejtoreshave mund te delegoje pjese te pushtetit te vet tek Kryetari dhe / ose Asistenti I Pergjithshem Menaxherial, duke siguruar delegim te tille do te jete per nje periudhe te percaktuar dhe te shkurter kohe dhe e publikuar si prone ne regjistrat speciale tregtare te kompanive.

43 2 Pushteti I Kryetarit dhe Menaxherit te Pergjithshem:

Kryetari I Bordit dhe kur eshte e nevojshme Menaxheri I Pergjithshem ose Drejtori veprues si Menaxher I Pergjithshem, duhet te perfaqesoje kompanine kundrejt paleve te treta, te zbatoje rezolutat e Bordit te Drejtoreshave, dhe te drejtojë biznesin normal te Kompanise nen supervizimin e Bordit te Drejtoreshave dhe ne pershtatje me kushtet e ligjit dhe zakonit, dhe kushtet e statuseve aktuale.

43 3 Nenshkrimet e Kompanise:

43 31 Kompania duhet te jete e kufizuar nga firma e Kryetarit veprues brenda fushes se pushtetit te akorduar atij, ose nga firma e Menaxherit te Pergjithshem ose Drejtorit veprues si Menaxher i Pergjithshem, ne baze te rezolutave te ndermara nga Bordi I Drejtoreshave ne respekt te kesaj.

43 32 Kryetari ose Menaxheri i Pergjithshem duhet te akordojë te nje pale e treta, jo anetar te Bordit te Drejtoreshave, te drejten per te firmosur e pergjithesi ose ne vecanti ne emer te Kompanise, me qellim per te drejtuar disa veprime te lidhura me biznesin normal te kompanise dhe brenda limiteve te percaktuara.

43 33 Nese perfaqesuesit e kompanise veprojne pertej fushes se pushtetit te akordura tek ata, kompania duhet vetem te jete e kufizuar vetem ne askte te autorizuar ose aprovuar nga mbledhja e aksionareve

44 Detyrimet e Bordit te Drejtoreve:

Bordi I Drejtoreve duhet te veproje ne perputhje me kerkesat e imponuara nga ligji; dhe ne vecanti:

- Te sigurohet rreth krijimit te kompanise ne perputhje me ligjet (ky detyrim bie vetem mbi Bordin e pare te Drejtoreve).
- Te zhvilloje procedura ligjore lidhur me publikimet, depoziten dhe regjistrimin si prone ne regjistrin special tregtar te kompanive.
- Te zbatoje rezolutat e mbledhjeve te pergjithshme.
- Te pergatise ne fund te gjashte muajve te pare te vitit financiar, deklarate koncize qe tregon aktivin dhe pasivin (pronesine dhe detyrimet) e Kompanise.
- Te pergatise ne fund te cdo viti financiar nje raport mbin aktivitetin e kompanise dhe deklarate te llogarive te tij, inventarin, bilancin, perfitimet dhe humbjet e kompanise dhe te vendose ato ne dispozicion te auditoreve te pakten 50 dite perpara thirrjes se mbledhjes vjetore te pergjithshte te aksionereve.
- Te telefonoje mbledhjet e pergjithshme te zakonshme dhe te jashtezakonshme dhe te caktoje axhenden e tyre.
- Te parashtroje propozimet ne mbledhjet e pergjithshme te jashtezakonshme duke respektuar cfare ata gjejne te nevojshmete futet ne artikujt e Kompanise si amendamente.
- Te caktoje rezervat ligjore dhe te percaktoje sasite, te cilat ata gjejne te zbriten per zhvleresime dhe te parashtrojne propozimet ne Mbledhjet e pergjithshme te zakonshme duke respektuar shperndarjen te fitimeve sipas zbritjes se rezervave ligjore.
- Te publikoje bilncin e fund vitit financiar, emrat canetareve te Bordit te Drejtoreve dhe te Auditoreve, ne regjistrin special tregtar te pronave te kompanive, brenda dy muajve pas dates se aprovuar te llogarive nga mbledhja e pergjithshme.

44 Pergjegjesite e Drejtoreve:

- 45 1 Drejtoret duhet te jene pergjegjes, bile edhe kundrejt paleve te treta, per te gjitha aktet e mashtrimeve dhe per aktet e kryera nga ata ne shkelje te ligjit ose te statusave aktuale.
- 45 2 Ne parim, Drejtoret nuk duhet te jene pergjegjes ndaj paleve te treta, per gabimet e administrates ne anen e tyre, me perjashtim te deklarimit te falimentimeve te kompanise ose likuidimeve ligjore qe tregojne mungese pronesish.
- 45 21 Ne kete rast, Gjykata Tregtare duhet te caktoje nje sasi te debiteve te kompanise qe duhet te mblidhen nga Drejtoret dhe duhet te vendoset nese ata jane pergjegjes se bashku apo jo.
- 45 22 Te mohojte pergjegjesite e tyre, Drejtoret duhet te provojne qe ata kane menaxhuar kompanine me zellin e rrogetarit.
- 45 3 Drejtoret duhet te jene pergjegjes ndaj aksionereve per gabimet e administrates ne anen e tyre.
- 45 31 Drejtoret jane pergjegjes se bashku ose individualisht, sic mund te jete rasti.
- 45 311 Ne rastin e nje pergjegjesie te perbashket, te gjitha Drejtoret duhet te jene pergjegjes per te paguar demin, per deri sa disa nga Drejtoret s'kane protestuar

ende kundrejt rezolutave te adaptuara pavaresisht nga ata dhe perfshire edhe protestimin e tyre me minuta.

45 312 Ndarja finale e pergjegjesive ndermjet Drejtoreve do te ndermerret ne perputhje me vendin e secilit prej tyre ne gabimin e ndermarre.

46 Shperblimi I Drejtoreve:

46 1 Drejtoret duhet te shperblehen edhe me nje shperblim vjetor, ose nga shperblimi I Drejtoit, ose nga nje ndarje ne fitim neto, ose nga kombinimi I te gjitha ketyre avantazheve te ndryshme.

46 2 Drejtoret duhet te rimbursohen per kostot e udhetimit dhe shpenzimet e pcerfaqesimit te kerkuar qe mbart funksioni I tyre.

46 3 Shperblimi I Kryetarit veprues si Menaxher I Pergjithshem dhe I drejtorit con deri ne fund funksionet efektive ne kompani,, duhet te jete e vendosur paraprakisht nga Bordi I Drejtoreve ne perputhje me kushtet e artikullit 153 te ligjit komercial.

Kapitulli V AUDITORET

50 Emerimi I Auditoreve:

Kompania duhet te emeruje te pakten nje auditor me rezidence ne Liban dhe nje me nacionalitet libanez. Ai mund te emerohet per tre vjet.

51 Atribuimet dhe detyrat e Auditoreve:

51 1 Auditoret duhet te supervizojne te perhershme drejtimin e biznesit te kompanise. Ata duhet te kene akses ne te gjitha dokumentat dhe llogarite dhe duhet te telefonojne Drejtoret per te furnizuar ata me ndonje informacion te kerkuar ne perputhje me kushtet e ligjit.

51 2 Auditoret duhet te pergatisin nje raport qe do te paraqitet ne mbledhjen e pergjithshme te aksionareve mbi situaten e kompanise, bilancin dhe llogarite e vendosura nga Bordi I Drejtoreve, dhe mbi propozimet e ndarjen e dividendeve, ne perputhje me kushtet dhe brenda limitit kohor te kushtezuar nga ligji.

51 3 Auditoret duhet gjithashtu te njoftojne mbledhjen e akisonereve nese Drejtori refuzon ta beje ate dhe ne ndonje nga titullaret e specifikuar nga ligji dhe statuset aktuale.

51 4 Auditoret duhet te jene pergjegjes se bashku ose individualisht, edhe ndaj paleve te treta, per gabimet qe jane ndermarre gjata auditimit, subjekt per pershkrim.

Kapitulli VI MBLEDHJET E AKSIONEREVE

60 Natyra e mbledhjeve :

Mbledhjet e aksionereve jane: mbledhja kushtetuese, mbledhjet e zakonshme dhe mbledhjet speciale .

61 Caktimi i Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionereve:

61 1 Mbledhja kushtetuese:

Mbledhja kushtetuese duhet te siguroje qe kompania ka qene e informuar ne kohen e duhur dhe do te miratoje te gjitha rezolutat per formimin e Kompanise ne perputhje me kushtet e ligjit.

61 2 Mbledhja e zakonshme:

61 21 Mbledhja e zakonshme e aksionareve duhet te mbahet cdo vit ne Liban, brenda pese muajve pasardhes te perfundimit te vitit financiar, sic eshte caktuar ne statutet aktuale.

Ajo do te mbahet gjithashtu disa here ne te njejtin vit financiar ne baze te ngjarjeve te paparashikurara qe mund te ndodhin ose ceshtjeve urgjente.

61 22 mbledhja e zakonshme e aksionerëve do të diskutojë, dhe aty Kr është e mundur të aprovojë llogaritë e vitit të kaluar financiar; më pas ajo do të diskutojë dhe miratojë rezolutat që e tejkalojnë qëllimin e kompetencave të Bordit të Drejtorëve me kusht që rezoluta të tilla të mos modifikojnë statutet e kompanisë. Ajo do ti japë gjithashtu Bordit të Drejtorëve të gjitha autorizimet e nevojshme për të veprime që e tejkalojnë qëllimin dhe kompetencat që I janë deleguar dhe do të përcaktojë kushtet e këtij autorizimi.

61 3 Mbledhjet e Vecanta

aksionerët mund që në një mbledhje të veçantë të kalojnë rezoluta për të përmirësuar statutet e kompanisë me kusht që këto ndryshime të mod ndikojnë në kombësinë e kompanisë, në rritjen e obligimeve të aksionerëve e në të drejtat e palëve të treta.

61 Thirrja për Mbledhje të Përgjithshme :

62 1 E drejta për të thirrur Mbledhjet e Zakonshme dhe të Veçanta të Aksoinerëve kryesisht I jepet Bordit te Drejtorëve; dhe e drejta për të thirrur Mbledhjen Kushtetuese I jepet promotorëve.

Auditorët mund që në këtë kuadër të veprojnë në vend të Bordit të Drejtorëve në rastet e aprovuara me ligj dhe statuti aktual.

62 2 Njoftimet për mbledhjet e aksionerëve do të publikohen në dy gazeta ditore lokale ose do të dërgohen tek aksionerët me anë të postës së regjistruar, ose me ndonjë mjet tjetër të sigurt, gjashtëmbëdhjetë ditë të paktën para datës së caktuar për mbledhjen.

62 21 Ky afat kohor mund të ulet në tetë ditë nëse mbledhja mbahet për herë të dytë ose të tretë.

62 22 Njoftimi do të caktojë datën dhe vendin e mbledhjes dhe do të përcaktojë qartë dhe në mënyrë të përmbledhur agendën e takimit.

62 3 mbledhja e aksionerëve mund të mbahet pa njoftim nëse të gjithë aksionerët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin janë prezent ose të përfaqësuar.

62 4 mbledhja e aksionerëve mund të mbahet jashtë territorit libanez përveç mbledhjes vjetore të aksionerëve, e cila duhet të mbahet në Liban.

62 Përbërja e Mbledhjeve të Përgjithshme :

63 1 Secili Aksioner, panvarësisht nga numri I aksioneve që zotëron, do të ketë të drejtën të marrë pjesë në mbledhje të ndryshme të përgjithshme që mbahen për të krijuar kompaninë dhe për të drejtuar punën e saj.

63 2 secili aksioner, panvarësisht nga lloji I aksioneve që zotëron, dhe panvarësisht se ka vetëm një certifikatë të përkohshme në lidhje me aksionet që nuk janë likuiduar plotësisht, do të ketë të drejtën e votës.

63 21 në parim, çdo aksioner do të ketë aq vota sa numri I aksioneve që zotëron ose përfaqëson.

63 3 aksionerët që nuk janë në gjendje të ndjekin mbledhjet e aksionerëve mund të caktojnë aksionerë të tjerë për ti përfaqësuar ata. Megjithatë, përfaqësuesit lokal të personave të pamundur, nuk kanë pse të jenë vetë aksionerë.

63 Mbledhjet e Aksionerëve :


Sesionet – Diskutimet – Rezolutat :

64 1 Sesionet :

64 11 Mbledhjet e Aksionerëve do të mbahen sipas parashikimeve të bëra me ligj; Kryetari I Bordit të Drejtorëve do të drejtojë mbledhjen e aksionerëve dhe në mungesë të tij, Nën-Kryetari ose Drejtori do të veprojë përkohësisht si Kryetari. Në të kundërt, aksionerët do të zgjedhin një nga Drejtorët që është prezent si drejtues të mbledhjes.

64 12 Një komitet I mbledhjes do të krijohet dhe do të jetë I përbërë nga të paktën Kryetari dhe një Sekretar.

64.13B Në çdo sesion , një fletëpjesëmarrjeje do të shpërmdahet tek të gjithë aksionerët që do të jenë prezent ose përfaqësuesve të tyre. Në këtë fletë do të tregohen emrat dhe adresat e të gjithë aksionerëve, si dhe numrin e aksioneve që ka secili prej tyre si dhe numrin e votave sipas aksioneve.
Kjo fletë do të depozitohet në zyrën qendrore të kompanisë dhe çdo aksioner mund të njihet me të.



64.2 MARRJA E VENDIMEVE:

64.21 Vendimet e marra në mbledhjet e përgjithshme të aksionerëve do të jenë të të vlefshme vetëm nëse ndiqen nga një numër aksionerësh që përfaqësojnë kuorumin ligjor që duhet për çdo mbledhje.

64 22 aksionerët nuk do të diskutojnë çështje të cilat nuk janë në agendën e ditës. Çështje të paparashikuara ose urgjente që mund të dalin gjatë zhvillimit të mbledhjes janë të pritshme.

64 23 nëse aksionerër që janë prezent e konsiderojnë si të rëndësishëm faktin se ata nuk janë informuar mjaftueshëm për çështjet e shtruara para tyre, mbledhja, me kërkesë të një të katërtës së aksionerëve prezent, do të shtyhet për tetë ditë.

64 3 Vota :

64 31 Voto do të tregohet me një ngritje duarsh ose me lexim me zë të lartë, ose me anë të çdo mjeti tjetër publik të vendosur nga aksionerët.

64 32 me kërkesën e një aksioneri, votimi do të bëhet I fshehtë për çështje me karakter personal, si p.sh heqja nga detyra e një Drejtori ose pasojat e detyrimeve për veprimet e tyre.

64 33 asnjë aksioner nuk mund të votojë, as personalisht, as me prokurë, mbi një rezolutë me anë të të cilës ai merr një përfitim privat, ose një rezolutë që ka lidhje me një grindje midis tij dhe kompanisë.

64 4 Rezolutat :

64 41 Rezolutat e Mbledhjeve të Aksionerëve do të miratohen me shumicë votash të përcaktuara me ligj për çdo mbledhje.

64 42 Rezolutata e miratuara në kohën e duhur në prezencën e kuorunit dhe nga shumica e kërkuar në bazë të çdo mbledhjeje, pa mashtrim ose abuzim pushteti, do të jenë të detyrueshme për të gjithë aksionerët duke përfshirë si ato që janë prezent edhe që janë kundra.

64 5 Procesverbali I Mbledhjeve :

64 51 Zyrëtarët e mbledhjeve të aksionerëve do të përgatisin dhe nënshkruajnë procesverbalet e çdo sesiioni. Këto procesverbale do të regjistrohen në një regjistër të veçantë në zyrën qendrore të kompanisë.

64 52 Procesverbalet e mbledhjeve të hartuara në përputhje me ligjin dhe statutet prezente do të jenë një provë ligjore vendimtare për të gjitha çështjet e përfshira në procesverbale të tilla, vetën nëse jepet provë për të kundërtën që është e pranueshme patjetër.

64 53 Kopjet e pjesëve të procesverbaleve të tilla që kanë qëllim ti jepen palëve të treta do të verifikohen patjetër nga Kryetari I Bordit ose nga dy prej Drjtorëve.

Chapter VII

VITI FINANCIAR, INVENTARI,

DHËNIA FONDEVE DHE SHPËRNDARJA E PËRFITIMEVE

70 Viti Financiar :

70 1 Viti financiar do të fillojë për vit në 1 Janar dhe do të përfundojë në 31 Dhjetor.

Megjithatë, viti I parë financiar do të mbulojë vetëm periudhën nga data e krijimit përfundimtar të kompanisë dhe regjistrimin e saj në regjistrin tregtar deri në 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

70 2 aktet e zbatuara nga organizatorët në emër të kompanisë gjatë periudhës së krijimit të saj, do të bashkangjiten në vitin e parë financiar.

71 Raportet, Inventari dhe Llogaritë :

71 1 Në fund të gjashtë muajve të parë të vitit financiar, Bordi I Drejtorëve do të përgatisë një raport konçiz mbi aktivet dhe pasivet e kompanisë. Më pas, Bordi I Drejtorëve do të përgatisë, në fund të çdo viti financiar, një Inventar, një Bilanc dhe një Llogari mbi Përfitimet dhe Humbjet.

71 11 Inventari, Bilanci dhe Llogaria mbi Përfitimet dhe Humbjet do të vihen në dispozicion të Auditorëve pesëdhjetë ditë të paktën para datës së Mbledhjes Vjetore të Aksionerëve.

71 2 Inventari, Bilanci, Llogaritë E Përfitimit dhe Humbjeve, lista e aksionerëve, raportet e Bordit të Drejtorëve dhe Auditorëve të kompanisë; si dhe Përfitimi I Konsoliduar dhe Llogaritë e Humbjes, Bilanci I Konsoliduar, nëse ka, dhe raporti I Auditorëve që I përket këtyre dy llogarive të përmendura me sipër, do të depozitohen në Zyrën Qëndrore të Kompanisë pesëmbëdhjetë ditë të paktën para datës së caktuar për Mbledhjen Vjetore të Aksionerëve.

71 21 të gjithë aksionerët dhe zoteruesit e bonove mund të kenë akses për këto llogari dhe raporte në Zyrën Qëndrore të Kompanisë.

71 22 Personat e interesuar mund të marrin ose të kërkojnë për të marrë, me shpenzimet e tyre, kopje të të gjitha dokumenteve të sipërpërmendur, përveç Inventarit.

71 3 Drejtorët do të publikojnë për vit, në 'kompanitë holding (financiare)' një regjistër të veçantë tregtar, Bilancin e vitit të përfunduar financiar, emrat e anëtarëve të Bordit dhe Auditorëve të kompanisë, brenda dy muajsh që vijojnë aprovimin e llogarive që kanë lidhje me vitin e kaluar financiar nga Mbledhja Vjetore e Aksionerëve.

72 Dhënia Fondeve Dhe Shpërndarja E Përfitimeve

72 Fitimet Neto

72 1 Fitimet Neto të kompanisë do të konsistojnë në të ardhurat e vitit financiar siç është deklaruar në Inventarin vjetor, pas heqjes së të gjithë shpenzimeve të përgjithshme dhe tarifave të tjera financiare, duke përfshirë interesat dhe taksat si dhe shumat e dhëna për zhvlerësimin e parasë dhe rezervave të veçanta që duhen për të mbuluar kompaninë kundër risqeve.

72 2 Rezerva Ligjore :

Bordi I Drejtorëve duhet të vënë mënjanë një 10% të përfitimeve neto të kompanisë, pasi kanë hequr humbjet e mëparshme për të krijuar një fond rezervë ligjor deri atë kohë meqënëse shumat e lënë mënjanë është ekuivalente me një të tretën e kapitalit të kompanisë.

72 3 Rezervat Fakultative, Bilanci I çuar përpara :

Aksionerët mund që në mbledhjen e tyre vjetore dhe me rekomandim nga Bordi I Drejtorëve të heqin nga përfitimet neto, siç është parashikuar në paragrafin 72 1, shumat që I konsiderojnë si të duhura për të çuar përpara llogaritë e mëposhtme ose për të dhënë për një ose disa fonde te veçanta rezervë, të përgjithme ose të veçanta.

72 4 Përfitimet që duhen Shpërndarë :

72 41 Përfitimet që duhen shpërndarë do të konsistojnë në përfitimet neto pas heqjes së rezervës ligjore dhe shumat e dhëna dhe do të shpërndahen siç është parashikuar në paragrafët 72 2 dhe 72 3.

72 42 Shpërblimi I Drejtorëve I bërë nga një aksion në përfitime neto, siç është përcaktuar në paragrafin 46 1 do të hiqet, nëse del si çështje, nga përfitimet që do të shpërndahen të cilat janë përcaktuar më sipër.

72 5 Shpërndarja e Përfitimeve dhe Humbjeve :

Pagesa e Dividentëve :

72 51 Bilanci që mbetet pas heqjes së shumës nga përfitimet që duhen shpërndarë, nga aksionet në përfitimet e caktuara për Drejtorët do të shpërndahet midis aksionerëve si dividendë në proporcion me aksionin e secilit prej tyre që kanë në kapitalin e kompanisë.

72 511 Pagesa e dividendëve do të kryhet për vit në datat dhe vendet e përcaktuara nga Mbledhja e Aksionerëve, ose nga Bordi I Drejtorëve në rast se Mbledhja e Aksionerëve dështon në përcaktimin e tyre.

72 512 Dividentët që nuk janë pretenduar brenda pesë viteve që nga data e caktuar për pagimin e tyre do të caktohen në përfitim të kompanisë.

Kapitulli VIII

PEZULLIMET, SHPËRNDARJA, LIKUIDIMET

80 Pezullimet:

80 1 Kohëzgjatja e kompanisë mund të shtrihet me anë të një rezolute të aprovuar në një mbledhje të veçantë të aksionerëve.

80 2 Vendimi I pezullimit do të publikohet në përputhje me ligjin.

81 Shpërndarja :

Kompania do të shpërndahet me skadencën e kohëzgjatjes së saj siç është caktuar në statut vetëm në rast se zgjatet me anë të një rezolute të miratuar në një mbledhje të veçantë të aksionerëve ose me mbarimin e projektit për të cilin kjo kompani është krijuar, ose në pamundësi të vazhdimit të saj.

81 2 kompania do të shpërndahet gjithashtu me vendim të marrë nga aksionerët në një mbledhje të veçantë.

81 3 në rast të humbjes së tre të katërtave të kapitalit, Bordi I Drejtorëve menjëherë do të bëjë një mbledhje të veçantë për të përcaktuar nëse rrethanat e justifikojnë shpërndarjen e kompanisë përpara përfundimit të afatit të aktivitetit të saj ose për të miratuar masa të tjera të tilla si e konsiderojnë ata të përshtatshme.

81 4 kompania mund të shpërndahet gjithashtu me anë të Gjykatës Tregtare për arsye të drejta me kërkesë të një aksioneri.

81 5 shpërndarja e kompanisë nuk do të ketë ndonjë efekt mbi palët e treta përpara datës së regjistrimit të saj në regjistrin special të 'kompanive financiare'.

81 6 shpërndarja e kompanisë nuk do të japë fundin detyrës së Auditorëve të kompanisë të cilët do të kontrollojnë likuidimin.

82 Likuidimi :

82 1 Caktimi I Likuiduesve :

82 11 Likuidimi I kompanisë do të kryhet nga Kryetari ose Manaxheri I Përgjithshëm që është në detyrë në kohën kur ndodh shpërndarja e kompanisë.

82 12 Aksionerët mund të preferojnë të caktojnë një ose më shumë Likuidues me anë të një vendimi të miratuar nga ta në një mbledhje të zakonshme, përveç rastit kur kompania është shpërndarë më parë afatit të përcaktuar në statute. Në këtë rast, Likuiduesit do të caktohen me anë të një vendimi të miratuar në të njëjtën mbledhje të veçantë të aksionerëve e cila vendos për shpërndarjen.

Në mungesë të marrjes së një vendimi nga mbledhja e aksionerëve, Gjykata Tregtare do të caktojë Likuiduesit.

82 13 Megjithatë, nëse kompania shpëndalet me anë të një vendimi gjyqësor, I njëjti vendim do të përfshijë caktimin e Likuiduesve.

82 2 Shpërblimi I Likuiduesve :

Shpërblimi I Likuiduesve do të përcaktohet me vendimin që I cakton ata për të vepruar si të tillë.

82 3 Kohëzgjatja në Detyrë :

Likuiduesit do të qëndrojnë në detyrë deri në fund të mbylljes së veprimeve për likuidimin e kompanisë, përveç rastit kur është marrë një vendim I kundërt nga aksionerët.

82 4 Heqja nga Detyra e Likuiduesve:

Heqja nga detyra dhe zëvendësimi I një Likuiduesi do të udhëhiqet nga të njëjtat rregulla që janë aplikuar për caktimin e tij në detyrë.

82 5 Kompetencat dhe Detyrat :

82 51 Likuiduesi do të përfaqësojë kompaninë dhe do të ketë kompetencat më të mëdha, duke përfshirë të drejtën për të kryer marrëveshje miqësore me qëllim që të realizojë aktivet e kompanisë, të paguajë pasivet e maturuara dhe të shpërndajë bilancin e duhur.

82 511 Likuiduesi nuk mund të kryejë biznese të mëdha ose të ndërmarin biznese të reja, vetëm në rast se janë të autorizuar nga aksionerët ose Gjykata në përputhje me procedurën dhe kushtet e caktimit të tij në punë.

82 52 Drejtorët do të japin llogari për administrimin e tyre tek Likuiduesit për periudhën që është midis aprovimit të Bilancit të fundit në mbledhjen e aksionerëve dhe datën e caktimit të likuidimit. Likuiduesit mund të aprovjnë këtë llogari ose ti referohen Gjykatës për veshitësitë që mund të dalin.

82 53 Më pas, Likuiduesit duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat e vëna nga ligji.

82 531 Nëse likuidimi zgjatet me mbi një vit, Likuiduesit duhet që në këtë rast të përgatisin dhe të publikojnë Bilancin vjetor.

82 532 Me përfundimin e detyrës së tyre, Likuiduesit do të përgatisin një Bilanc të fundit duke treguar pjesën e secilit aksioner në aktivet e kompanisë.

82 6 Mbikqyrja e Likuidimit :

Auditorët do të mbikqyrin likuidimin dhe do të hartojnë një raport mbi llogaritë e dhëna nga Likuiduesit. Këto llogari mund të aprovohen nga Mbledhja e Zakonshme e Aksionerëve e cila do ti japë Likuiduesve lirin dhe shkarkimin nga detyrimi. Nëse llogaritë në fjalë nuk aprovohen, problemi do ti drejtohet Gjykatës.

82 7 Rezultatet e Likuidimit :

Me mbylljen e likuidimit, aktivet e kompanisë, nëse ekzistojnë, do të ndahen midis aksionerëve në përputhje me ligjin.

PROCESET GJYQËSORE, PUBLIKIMET, SHPENZIMET, KLAUZOLA TË NDRYSHME

90 Proceset Gjyqësore :

90 1 Të gjitha proceset gjyqësore që mund të dalin gjatë funksionimit të kompanisë ose gjatë periudhës së likuidimit, qoftë midis aksionerëve ose ndërmjet tyre dhe kompanisë ose Bordit të Drejtorëve, në lidhje me aktivitetet e kompanisë ose në lidhje me interpretimin a zbatimin e një prej klauzolave të statutit aktual do të rregullohet në bazë të parashikimeve të bëra me ligj. Këto çështje gjyqësore do ti drejtohen Gjykatës me juridiksion kompetent në vendin ku Zyra Qëndrore është vendosur.

90 2 Kështu, çdo aksioner duhet të zgjedhë banimin e tij në zonën e juridiksionit të Zyrës Qëndrore të Kompanisë ku të gjitha denoncimet e nevojshme dërgohen aty. Në të kundërt, zyra e nëpunësit të Gjykatës së Shkallës së Parë me juridiksion kompetent aty ku Zyra Qëndrore është vendosur do të konsiderohet si vendbanimi i zgjedhur i aksionerit.

91 Përbërja Finale e Kompanisë :

Kompania është e detyruar të vendoset përfundimisht pas kryerjes së të gjitha formaliteteve të detyruara me ligj dhe regjistrimin e kompanisë në regjistrin e veçantë tregtar të 'kompanive financiare' që mbahet nga Gjykata e Shkallës së Parë të Beirutit.

92 Formalitetet e Ndryshme për Botimet :

Kompania do ti nënshtrohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj botimeve të përherëshme të kërkuara me ligj.

93 Shpenzimet e Formimit :

93 1 të gjitha shpenzimet dhe harxhimet e nevojitura për krijimin dhe regjistrimin e kompanisë duke përfshirë shpenzimet e siguracioneve të aksioneve, taksa të ndryshme, studime dhe faturat e avokatëve, etj..... do të bëhen nga kompania.

932 Të gjitha shpenzimet e sipërpërmendura do të vihen në llogaritë e shpënzimeve të përgjithshme të kompanisë dhe do të amortizohen përpara çdo shpërndarjeje të fitimit në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve.

ORGANIZATORËT

Avokati TONI FOUARD EL MAALOULY

Avokati ANDRE BOULOS SAADE

Znj. NIDAL HIKMAT YOUNES

WALTER
TIRANA